REPUBLIKA E SHQIPËRISË

FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR
DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___. 2026

N J O F T I M P Ë R V E N D T Ë L I R Ë P U N E

Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor shpall vend të lirë pune për:

- **1 (një) Drejtor Drejtorie, pranë Drejtorisë së Kontrollit në Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.**

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kushte:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të përmbushë kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës;
- Të jetë në kushte shëndetësore të mira për të kryer detyrat përkatëse;
- Të mos jetë dënuar për vepra penale dhe të mos ketë proces në prokurori apo gjykatë;
- Të mos jetë pushuar më parë nga administrata e FSDKSH-së apo Shërbimi Civil për thyrje të disiplinës a shkelje të tjera serioze;
- Të ketë mbaruar arsimin e lartë në Ekonomi/Drejtësi/Mjekësi/Farmaci;
- Të jetë i pajisur me diplomën përkatëse;
- Të ketë eksperiencë pune mbi 5-vjet;
- Aftësi drejtuese dhe komunikuese;
- Njohuri bazë në kompjuter;
- Zotërimi i gjuhëve të huaja do të jetë avantazh; (dëshmi,çertifikata).

Të interesuarit duhet të paraqesin dokumentat pranë Drejtorisë Qëndrore të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, **brenda datës 12.11.2026**, si më poshtë;

- Kërkesë me shkrim për t'u punësuar;
- Jetëshkrimi i plotësuar (CV);
- Diplomë (për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit);
- Diplomë Master;
- Listë notash;
- Çertifikatë për gjuhët e huaja apo kualifikime të ndryshme;
- Referencë pune nga vendi ose vendet e punës ku ka punuar;

- Librezën e Punës ose (fotokopje të noterizuar) që vërtetojnë eksperiencën në punë;
- Çertifikatë Kompjuteri;
- Çertifikatë familjare;
- Fotokopje e kartës së identitetit (ID);
- Dëshmi penaliteti (të datojë brenda 3 muajve të fundit);
- Raport mjekësor për aftësi në punë (të datojë brenda 3 muajve të fundit).

Të gjitha dokumentat duhet të jenë origjinale ose fotokopje të noterizuara. Dokumentat të dorëzohen në zarf të mbyllur me rrugë postare.

Adresa:

Drejtoria e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Rr.“Sami Frashëri”, nr.8, Tiranë. Tel +3554223815.